



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:253427

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06100579

KF.nr.457/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULLI, dhe me zyrtaren ligjore Vesa Statovci, në kontestin tregtar administrativ të paditësi “Asgeto” sh.p.k, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson SCLR Partners - Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlera e kontestit 22,632.36 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit Gentiana Behluli, nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, dhe përfaqësueses së autorizuar të paditurit K.Sh., me datë 01.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Asgeto” sh.p.k, me seli në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.01.3.2.2/787/2018 i datës 29.09.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/787/2018 të datës 29.09.2021, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabueshëm të dispozitave materiale të Kodit Doganor dhe vendimit mbi gjobën, me propozim që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar, të anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/787/2018 të datës 29.09.2021, dhe të obligohet i padituri që paditësit t’ia kthejë mjetet monetare në shumë të përgjithshme prej 22,632.36 €, si dhe kamatën ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë. Në

seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e autorizuar e paditësit deklaron: Mbetemi në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe të gjitha deklarimeve në padi, konsiderojmë se e paditura nuk ka vepruar konform vërejtjeve të dhëna nga gjykata e cila ka shqyrtuar fillimisht padinë e paditësit dhe ka vendosur sipas aktgjykimit A.nr.482/19 të datës 04.06.2021, ku sipas këtij aktgjykimi është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar vendimi i kontestuar i të paditurës. Paditësi nuk ka importuar mall i cili sipas të paditurës nuk i plotëson kushtet ligjore për tu trajtuar si mall promovues i cili nuk paguan detyrime doganore, por malli ka qenë paketime të cilat brenda nuk kanë pasur mall, por kanë qenë paketime të cilat kanë shërbyer vetëm për reklamim të mallit, dhe nuk qëndron konstatimi i të paditurës se malli mund të përdorej edhe për qëllime tregtare, pasi edhe nga fotot e bashkëngjitura me padi shihet qartë diferenca midis mallit i cili tregtohet dhe mallit të importuar nga paditësi si produkt promovues i mallit në fjalë. Konsiderojmë se e paditura sipas vendimit të kontestuar nuk ka vepruar sipas rekomandimeve të gjykatës, sipas së cilës e paditura do të duhej të deklarohej në lidhje me faktin pse nuk është pranuar sasia e këtij malli për qëllime promovuese, edhe pse në rastin konkret nuk kemi pasur të bëjmë me rabat, por malli ka qenë kuti të zbrazura me qëllim promovimi. Dërgues i mallit është një kompani serioze “Dr. Theis”, ka dërguar për Doganën e Kosovës, një sqarim në lidhje me mallin kontestues, mirëpo e paditura nuk e ka marrë parasysh një deklaratë të tillë të lëshuar nga një kompani serioze. I ka propozuar gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të anulohet vendimi kontestues. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 25.01.2024, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës deklaron: Qëndrojmë pranë përgjigjes në padi dhe të thënat në aktvendimin e kontestuar, si dhe kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Dogana e Kosovës-SKI, sipas detyrës zyrtare dhe bazuar në nenin 82 të KDA-së, përmes sistemit të përpunimit të të dhënave të doganës, ka ushtruar kontrole pas dokumentarit të paditësit, pasi gjatë realizimit të importeve, ka shfrytëzuar rabatin sasiar dhe nuk ka deklaruar drejtë vlerën e mallit, pasi malli i dhënë falas ka vlerë dhe duhet të deklarohet sipas KDA-së. Për këtë arsye edhe janë ndryshuar të dhënat në

deklaratën unike doganore kontestuese. Padiësi as gjatë zhvillimit të procedurës doganore dhe pas saj nuk ka arritur që me prova konkrete të dëshmoj arsyet vendimtare që kanë shërbyer për dhënien e rabait-zbritjes, sepse rabati sasior i pretenduar nuk i plotëson kushtet ligjore, ashtu siç janë cekur edhe në arsyetimin e aktvendimit kontestues. Pa ashtu, dogana sqaron se sikurse mallrat të ishin në formë të testit apo provës, në sasi të limituara, atëherë do të ishte e mundur që të njëjtat të liroheshin si mall promovues, mirëpo sasia si në rastin konkret është e madhe dhe përveç efektit reklamues shërbejnë edhe për funksionin bazë të saj dhe nuk dallon nga malli tjetër i deklaruar për zhdoganim. I ka propozuar gjykatës që të marrë aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pa-bazuar kërkesëpadia e padiësit, duke e lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 01.08.2024, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimin me numër 787/2018 të datës 29.09.2021, Aktvendimin me numër 787 të datës 23.01.2019, Aktvendimin me numër 2018-560/1 të datës 29.11.2017, Pro faturat 16141664.001, 16141645.001, 17178767.001, 17202356.001, Faturat 16141619.001, 16141637.001, 16142799.001, 16141628.001, 17178765.001, 17178774.001, 923/17, 17202379.001, DUD-at 8614, 5042, 10922, 2811, 9115, 25414, CMR, EUR1, deklaratën EX Z, pagesat bankare ndërkombëtare, përgjigjen në padi dhe ankesën e ushtruar në doganë me datën 24.12.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se Sektori për Kontroll Pas Importuese me Aktvendimin 03.1.1-2018-560/1 të datës 29.11.2017, nën pikën I të dispozitivit e ka obliguar subjektin në procedurë që në afat prej 10 ditësh të paguaj obligimet doganore, dhe atë taksën doganore prej 10 % në shumën prej 5,699.18 € dhe taksën e TVSH-së në shumën prej 16,933.18 €, gjithsejtë 22,632.36 €, ndërsa nën pikën II të dispozitivit ka ndryshuar të dhënat në

DUD-at me regjim IM4, R-8614/22.09.2016, R-2811/14.04.2017, R-25414/30.10.2017, R-5042/14.06.2016, R-10922/25.11.2016 dhe R-9115/31.08.2017 të proceduar në Zyrën Doganore Dheu i Bardhë. Me arsyetim se me rastin e zhdoganimit të mallit pala nuk ka deklaruar drejtë vlerën e mallit, pasi edhe malli i dhënë falas ka vlerë dhe duhet të deklarohet, ngase sipas KDA-së vetëm malli për reklama në sasi të vogla apo malli që jepet falas në panairë mund të lirohet nga taksat doganore, por jo edhe malli komercial si në këtë rast. Jo kontestues mbetet dhe fakti se subjekti ankimor ka parashtruar ankesë në Doganën e Kosovës e cila me aktvendimin 01.3.2.2/787 datës 23.01.2019 e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e subjektit ankimor. I pa kënaqur me këtë vendim subjekti në procedurë këtu paditësi ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, e cila me aktgjykimin A.nr.482/19 të datës 20.05.2021, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, dhe e ka anuluar aktvendimin 01.3.2.2/787 të datës 23.01.2019, dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Nuk është kontestues as fakti se Dogana e Kosovës duke vepruar sipas aktgjykimit të lartcekur ka sjell aktvendimin nr.01.3.2.2/787/2018 të datës 29.09.2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e kundër të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 11.11.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, të ushtruar ndaj aktvendimit 03.1.1-2018-560/1 të datës 29.11.2017 të Sektori për Kontroll Pas Importuese, si të pabazuar. Me arsyetim se Sektori për Kontroll Pas Importuese ka vepruar drejtë kur subjektit ankimor për DUD-at R-8614/22.09.2016, R-2811/14.04.2017, R-25414/30.10.2017, R-5042/14.06.2016, R-10922/25.11.2016 dhe R-9115/31.08.2017 të proceduara në Zyrën Doganore Dheu i Bardhë, nuk i ka pranuar rabatin/zbritjen e malli sipas faturës përcjellëse, për arsye se subjekti ankimor gjatë zhvillimit të procedurës doganore, por edhe pas saj nuk ka arritur që me prova konkrete të dëshmojë arsyet vendimtare të cilat kanë shërbyer për dhënien e rabatit (zbritjes) nga eksportuesi. Tutje ka theksuar se sikur mallrat të ishin në formë testi apo prove me sasi të limituar (një përdorimesh), atëherë do të ishte e mundur që të njëjtat të liroheshin në formë provë si reklamim të produktit, por sasia e mallrave apo e mallit në njësi është e asaj mase që përveç efektit reklamues, e njëjta shërben edhe për funksionin që ka, prandaj, nisur nga ky fakt arrihet deri tek përfundimi se malli lëndor nuk dallon asgjë nga malli tjetër i deklaruar për zhdoganim me vlerën reale të mallit, andaj, nuk mund të vlerësohet me vlerën minimale të deklaruar nga subjekti në procedurë. Tutje ka theksuar se Dogana e Kosovës ka konstatuar se

neni 97 i Kodit Doganor dhe i Akcizave i referohet atyre mallrave që përveç reklamacionit nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, prandaj mallrat e pretenduara të subjektit si mallra reklamues nuk hyn në domenin e mallrave që mund të përdoren për qëllime të tjera, pasi që të njëjta përdoren sikurse mallrat tjera për nga funksioni që kanë pavarësisht mënyrë së dhënies apo marrjes së tyre në kuptim të çmimit, prandaj nuk është kontestuese pretendimi i subjektit se të njëjtat janë dhënë me vlerë nominale, në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje ligjore si sasia, lloji, mënyra e shfrytëzimit të këtij mallit, përveç efekteve reklamuese ka edhe efektet të përdorimit të tij. Më tutje ka theksuar se dogana duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës i sqaron gjykatës dhe subjektit në anën tjetër se nëse qëndron fakti se mallrat lëndore janë dhënë gratis, në praktikën doganore të njëjtat janë paraqitur si rabate sasiore, por ajo që është më qenësore është se mënyra e paraqitjes si rabat apo dhënie gratis nuk e ndërron mënyrën e vendosjes, sepse vlera nominale është e atillë që Dogana nuk mund të pranoj, ndryshe shitësi i mallit edhe mund t'ia falë blerësit mallin, por kjo nuk nënkupton se Dogana mund t'ia pranojë vlerat si të tilla për qëllime të taksave doganore. Po ashtu, Dogana ka vlerësuar se çmimet e deklaruara nga subjekti nuk janë asgjë më shumë se sa simbolike, dhe vetë deklarimi si mallra reklamuese nënkupton se qëllimi i subjektit ka qenë që këto mallra ti fute me taksa minimale në emër të reklamacionit të tyre. Por siç i theksua më lartë Dogana këto mallra të deklaruara në sasi të mëdha si në DUD-at kontestues nuk mund ti pranoj si mallra reklamuese pasi që nuk hyn në kuadrin e mallrave të cilat do të mund të përfitonin lirim sasiore, pasi që siç u sqarua edhe më lartë, këto mallra përveç efektit reklamues kanë edhe efekte të përdorimit për natyrën që kanë, prandaj, Dogana e Kosovës refuzon kërkesën e subjektit lidhur me pretendimet e tij. Ndërsa lidhur me vërejtjen e gjykatës se Dogana duhet të sqaroj se si ka ardhur në përfundim për rivlerësimin e DUD-ave R-10922/25.11.2016 dhe R-9115/31.08.2017, duke mos ndarë se cilat emërtime janë kontestuar kur dihet mirë fakti se DUD-i R-10922/25.11.2016 ka gjithsejtë 23 emërtime ndërsa DUD-i R-9115/31.08.2017 ka gjithsejtë 15, dhe jo të gjithë janë kontestues, Dogana ka sqaruar se deri tek kontestimi i vlerës së deklaruar ka ardhur si rezultat i mos pranimit të mostrave të dërguara pa pagesë apo me vlera nominale, ashtu siç janë të cekura në DUD-at kontestues në emërtimet përkatëse si material reklamues-promovues dhe në faturat përcjellëse, dhe se të dhënat e ndryshuara dhe obligimin për pagesë shtesë në DUD-in R-10922/25.11.2016 i referohen emërtimit 23, ndërsa për DUD-in R-9115/31.08.2017 emërtimet 2, 3, 5 dhe 6.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë

pretendimet e paditësit të shprehura në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata pretendimin e paditësit se SKPI nuk i ka analizuar dokumentet e bashkangjitur Deklaratës Doganore, sepse nga këto dokumente mund të konstatohet lehtësisht se malli doganor është blerë sipas vlerës së faturës, e vlerëson si të pa bazuar për arsye se Dogana ka sqaruar se nuk e ka kontestuar dokumentacionin aty ku çmimet janë deklaruar sipas vlerës reale që kanë, mirëpo deklarimi i mallrave me vlerat simbolike prej 0.01 € është i pa pranueshëm, për arsye se qëllimi i subjekti këtu paditësi ka qenë që këto mallra ti fuste me taksë minimale në emër të reklamacionit të tyre, por Dogana ka theksuar qartë se këto mallra të deklaruara në sasi të mëdha si në DUD-in kontestues nuk mund ti pranoj si mallra reklamuese pasi që nuk hyn në kuadrin e mallrave të cilat mund të përfitojnë lirim sasior, këto mallra përveç efektit reklamues kanë edhe efekte të përdorimit për natyrën që kanë, prandaj nisur nga ky fakt arrihet deri te përfundimi se malli lëndor nuk dallon asnjë nga malli tjetër i deklaruar për zhdoganim me vlerën reale të mallit, andaj nuk mund të vlerësohet me vlerën minimale të deklaruar nga paditësi.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar pretendimin e paditësit se ky rivlerësim i mallit është në tërësi i pa bazuar, në kundërshtim me dispozitat e KDA-së dhe gjendjen faktike, ngase SKPI nuk ka arritur të kontestoj asnjë nga dokumentet e cekura, të cilat dëshmojnë vlerën e transaksionit, por në mënyrë arbitrare e ka rritur çmimin e mallit duke e ngritur atë, përkatësisht duke i'u referuar metodës së 6-të të vlerësimit, kjo për faktin se në rastin konkret SKPI ka konstatuar drejtë se subjekti në procedurë këtu paditësi me rastin e zhdoganimit të mallit nuk ka deklaruar dejtë vlerën e mallit, pasi që edhe malli i dhënë falas ka vlerë dhe duhet të deklarohet. Ngase sipas KDA-së, vetëm malli për reklama në sasi të vogla apo malli që jepet falas në panairë mund të lirohet nga taksa doganore, por jo edhe malli komercial si në rastin konkret. Prandaj, malli i paraqitur në DUD me çmime të ulëta me të drejtë është rivlerësuar duke u bazuar në faturat e palës, kjo për faktin se në të njëjtën faturë një sasi e mallit ka qenë me vlerë tjetër ndërsa sasia tjetër me çmim tjetër. Po ashtu, gjykata vlerëson se e paditura Dogana e Kosovës drejtë ka konstatuar se sasia e mallrave apo e mallit në njësi është e asaj mase që përveç efektit reklamues, e njëjta shërben edhe për funksionin që ka, andaj, nisur nga ky fakt me të drejtë është ardhur në përfundimi se malli lëndor nuk dallon asgjë nga malli tjetër i deklaruar për zhdoganim me vlerën reale të mallit, andaj nuk mund të vlerësohet me vlerën minimale të deklaruar nga subjekti.

Në vijim pretendimin e paditësit se e paditura ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar, ngase përveç të theksuarit në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38 par. 2 të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë kontest tregtar administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruësit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”*.

Nga këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuar nga paditësi, duke dhënë arsytim të mjaftueshëm, dhe duke sqaruar se lënda është rivlerësuar sipas metodës së tretë të vlerësimit për mallrat e ngjashme ashtu siç është në deklaratën eksportuese dhe në procesin për përcaktimi të vlerës së mallit.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, paragraf 1, dhe nenit 46, paragraf 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.457/22 datë 01.08.2024

Zyrtare Ligjore,  
Vesa STATOVCI

Gj y q t a r i,  
Fisnik NULI

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.